



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHË C (2)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 0 leksione / 40 seminare
Viti / Semestri : Viti I , semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor pranë Departamenteve të tjera FGJH
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Lënda **Gjuhë C (2)** i drejtohet studentëve të vitit të parë Bachelor (FGJH, UT), të cilët e zgjedhin atë si gjuhë të dytë. Lënda i shërben mësimin të gjuhës së huaj në nivelin e kontaktit apo të mbijetesës. Ajo i shërben gjithashtu praktikës sociolinguistike të koncepteve bazë morfo-sintaksore. Kjo është një lëndë me karakter formues si në njohjen e një gjuhe ashtu dhe në njohjen e kulturës së saj. Ushtrimet janë strukturuar në mënyrë të tillë që të verifikohet përvetësimi i tyre si në aspektin ngushtë gjuhësor ashtu edhe në atë kulturor

Objektivat specifike lëndore:

1. Të kuptojë fjali dhe shprehje të thjeshta të përdorura shpesh në lidhje me zonat e rëndësisë më të afërt. (P.sh informata themelore personale dhe familjare)
2. Të komunikojë në detyra të thjeshta dhe rutinë që kërkojnë shkëmbim të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë të informacionit mbi çështje të njohura dhe të zakonshme.
3. Të përshkruaj me terma të thjeshtë aspekte të jetës të mjedisit dhe çështje që lidhen me nevojat e menjëhershme.
4. Të përshkruaj e prezantoj në mënyrë të thjeshtë persona, situata nga jeta dhe puna, detyra të përditshme, të tregoj çfarë i pëlqen e çfarë jo.

Rezultate të pritshme:

1. Aftësia për t'u shprehur aq sa për të shkëmbyer informacionet bazë në komunikim.
2. Aftësia për të lexuar, dëgjuar dhe folur me fjali të shkurtra në gjuhën italiane. Nxitja e punës në grup, si një mënyrë mjaft efikase për përfshirjen e sa më shumë studentëve në procesin mësimdhënës dhe mësimnxënës.
3. Aftësia për të analizuar aspekte të ndryshme socio kulturore dhe përfaqshen e tyre me kulturën shqiptare